

FJALA E DEPUTETIT EDUARD NDRECA

E ENJTE 24 MARS 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Fort të nderuar qytetarë,

Më lejoni që, përpara se të filloj e të shoh këto letrat që kam shkruar, të bëj një reagim të shkurtër, në fakt, duhej të ishte shumë i madh në lidhje me atë që u përmend këtë për “21 janarin” dhe për Aleks Nikën. Këtë reagim e kam si deputet i Lezhës, por edhe si bashkëprotestues me Aleks Nikën më 21 janar. Ne, grupi i Lezhës, përveçse jemi kontrolluar 60 herë nga Lezha deri në Tiranë, u kontrolluam edhe brenda Tiranës, para se të niste protesta, kemi protestuar me duar në xhepa, si qytetarë të lirë të këtij vendi që ëndërron të jetë si të gjitha vendet e tjera europiane. Aleks Nika është vlarë pak metra larg meje dhe, si Aleks, mund të kisha qenë unë, mund të kishte qenë një pjesëtar i familjes sime apo kushdo tjetër.

Është abuzim i dyfishtë ta përmendësh atë që padrejtësisht e ke vlarë thjesht se protestoi për vendin e tij, për një jetë më të mirë e më të drejtë. Është turp e krim. Minimalisht, ata që e kanë bërë këtë vepër, duhej të heshtin, kjo është detyra kryesore që kemi. Drejtësia patjetër që duhet të flasë e, në mos foltë, shpresojmë që ka një Zot e gjithsecili do të marrë ndëshkim për atë që ka bërë. Projektligji që prezantoi ministrja sot, është mjaft i rëndësishëm dhe besoj të ketë marrë votën e të gjithë kolegëve. Përpjekja për t’i zgjeruar rrugët e komunikimit kulturor me Europën e më gjerë në çdo drejtim, çka parashikon edhe marrëveshja e sotme, është nisma e duhur që mund të ndërmerim. Lidhja ndërmjet kulturës është gjëja më e duhur për të forcuar të gjitha lidhjet e tjera. Komunikimi i kulturave është i lashtë sa vetë popujt dhe ka ndikuar jashtëzakonisht shumë në formimin e popujve që nga Antikiteti. Edhe sot lidhjet kulturore, të cilat do të konkludohen me këtë marrëveshje që do të kalojmë, do të ndikojnë shumë më shumë në afrimin mes anëtarëve të kësaj marrëveshjeje në fusha të ndryshme, si arsim, turizëm, art, politikë e kudo tjetër.

Përfshirja e aktorëve të ndryshëm në këtë lidhje kulturore, që nga shtetet deri te shoqatat, autoritetet lokale dhe rajonale, universitetet, organizatat e ndryshme etj., është një instrument tjetër që do të ndikojë në forcimin e lidhjes mes vendeve anëtare në këtë marrëveshje. Kjo marrëveshje e pjesshme e zgjeruar, rrjedhimisht do të kontribuojë mes vendeve anëtare në këtë marrëveshje. Kjo marrëveshje e pjesshme e zgjeruar rrjedhimisht do të kontribuojë edhe në ruajtjen me fanatizëm të vlerave të gjithanshme kulturore të vendeve pjesëmarrëse. I gjithë ky angazhim dhe e gjithë kjo përfshirje për të promovuar vlerat e gjithanshme kulturore, pa dyshim do të përkthehet edhe në përfitime ekonomike të anëtarëve dhe besoj shumë se ne, si vend i vogël, do të kemi përfitime të mëdha dhe, po u angazhuam seriozisht në vijimësi, pas kësaj marrëveshjeje do të kemi mundësi jo vetëm të përfitojmë ekonomikisht,

por të tregojmë natyrshëm përpara botës se sa vlejme dhe çfarë trashëgimie kulturore kemi, ndaj e vlerësoj shumë përpjekjen e ministres për të arritur deri këtu.

Nuk dua t'i përsëris ato që tha ministrja, sepse besoj se fjala e saj ishte shumë shteruese në lidhje me etapat e kësaj marrëveshjeje, bazueshmërinë ligjore të kësaj marrëveshjeje, përfitimet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, por dua ta kaloj diskutimin tim në një linjë tjetër që të mos bie në përsëritje. Gjerësisht në këtë marrëveshje flitet për trashëgimi të përbashkët dhe për ruajtjen e saj. Pra, ne dhe vendet anëtare europiane kemi trashëgimi të përbashkët dhe trashëgimia më e madhe e përbashkët që kemi, është vetë trualli europian, i cili, fatkeqësisht, sot është ndarë në anëtarë dhe joanëtarë të BE-së që jetojnë të pabarabartë në këtë trashëgimi të përbashkët; pak ironike duket. BE-ja duket se del zbuluar përballë përpjekjeve tona si shtet për të qenë anëtar i BE-së. Europa nuk duhet t'i lërë rrugëve bijtë, se del rreziku e t'i merr, pastaj gradualisht trashëgimia e përbashkët nuk është më e tillë. Kërcënimi rus besoj se është i mjaftueshëm për ta dëshmuar.

Forca ekonomike nuk duhet t'i fshijë gjitha elementet e tjera që vlejme për të treguar se ne jemi europianë sa vetë jeta mbi këtë truall. Ngurtësia që ka mbërthyer BE-në me kushte pas kushtesh, nuk shuhet veç me reformat që ndërmarrim ne me punët që bëjmë, sado të bëjmë e sado mirë t'i bëjmë, dhe këtë ne e dimë më së miri, përsëri do të dalin kushte të reja, sepse kohë të reja mbjellin kushte të reja që nuk janë njësoj me të parat. Europa nuk duhet t'i përsërisë gabimet e së shkuarës me heshtje dhe zvarrisje dhe që këto gabime të mos përsëriten besoj se nuk ka rrugë më të mirë se sa përafrimi kulturor mes popujve, intensifikimi i vazhdueshëm i lidhjeve kulturore shuan zjarrin e çdo dasie, ndaj kjo e sotmja duhet vlerësuar shumë dhe besoj të ketë marrë vlerësimin e secilit deputet. Më lejoni të ndaj me ju edhe disa mendime në lidhje me debatin që ndodhi këtu në krye të herës për rritjen e çmimeve.

Të gjithë e dimë, ju që s'doni ta dini prapë e dini, pra të gjithë bashkë e dimë se kriza e çmimeve është një krizë e ardhur për shkak të krizës ndërkombëtare. Pa dyshim që në vendin tonë ka abuzime me çmimet, dhe kjo duhet thënë dhe duhet kërkuar llogari, por besoj se reagimi i qeverisë për situatën e krijuar ishte i menjëhershëm. Madje, në një anë u bë mirë me këto bordet, të cilat duhet të vijojnë të funksionojnë edhe pas kalimit të gjendjes së jashtëzakonshme, sepse duhet ndëshkuar kushdo që abuzon në çdolloj kohe të jashtëzakonshme apo të zakonshme. Ajo që më habit, është se në një situatë, kur ne nuk kemi asgjë në dorë, në fakt, fajësohet sërish qeveria. Nëse opozita është e jo e gatshme të ndërtojë programe bindëse dhe konkurruese që e kthejnë atë në një alternativë serioze, nuk besoj se shpëtimi mund t'i vijë nga shfrytëzimi i një situatë të jashtëzakonshme dhe nga abuzimi me të.

Ndodhi tërmeti dhe, pa arritur dreka, u fajësua qeveria për mosangazhim. Ndodhi pandemia dhe, pa nisur mirë pandemia, sërish u akuzua qeveria për mosfunksionim e sërish në këtë gjendje të jashtëzakonshme akuzohet qeveria dhe hidhet baltë mbi të. Kur do të vijë ajo kohë që ne të mendojmë krejt ndryshe në situatë të jashtëzakonshme, minimalisht të jemi së bashku? Kam dëgjuar në fillim të pandemisë me shumë kureshtje fjalën e kryetarit të opozitës portugeze, nëse nuk gabo, i cili iu drejtua kryeministrit të tij, duke i thënë përafërsisht këto fjalë, ndonëse më parë gjuhën e komunikimit e kishin jashtëzakonisht të ashpër: "Ne ndahemi politikisht, por nga sot unë jam përkrah jush për ta përballuar së bashku fatkeqësinë që i ka rënë vendit tonë. Jam në dispozicion për t'i ndihmuar me sa mundemi qytetarët tanë". Ne, fatkeqësisht, nuk po mundemi dot ta bëjmë këtë gjë që për një moment të

harrojmë dasitë, sharjet, fyerjet me njëri-tjetrin e të bëhemi krah për të përballuar fatkeqësitë. Flasin këtu, shajmë, bërtasim, hedhim baltë mbi njëri-tjetrin dhe në korridor dalim e i themi njëri-tjetrit se e tepruam pak, po kështu e ka kjo punë. Largqoftë, në qoftë se na troket lufta në derë, ne sërish do ta luftojmë armikun në shumë fronte, pa harruar asnjëherë frontin kryesor: atë të baltosjes së njëri-tjetrit. Edhe po ndodhi kjo, nuk është hera a parë që e bëjmë.

Ju, si opozitë, kërkoni të jepni mesazhe fikse të zgjidhjes së situatës së krizës dhe “jeni të prerë” në zgjidhjet tuaja, doni ta mbani mirë edhe me qytetarët, edhe me tregtarët, sepse njëherë akuzoni qeverinë që nuk reagon për të kontrolluar rritjen abuzive të çmimeve, pastaj sa reagon qeveria ndaj rritjes abuzive, denonconi qeverinë, e shani qeverinë, sepse po hyn dhe po pengon ekonominë e tregut të lirë. Në një situatë të jashtëzakonshme, miq, ky rol i dyfishtë nuk ju bën nder dhe kriza e brendshme nuk duhet t’jua errësojë gjykimin mbi krizën që po kalon i gjithë vendi sot. Ju, si opozitë, duhet të jeni institucion i rëndësishëm në këtë vend, ashtu siç duhet të jemi ne nesër, sepse s’do të jemi gjithë kohën në pushtet. Kritikat e një opozite vizionare jo vetëm i japin pikë asaj, por i japin mundësi një qeverie të qeverisë edhe më mirë. Fatkeqësisht, edhe këtë opozitë në këto 8 vjet e kusur e kemi bërë vetë ne që jemi në pushtet.

Në lidhje me akuzat që hidhini, gaboni, të nderuar kolegë, sepse, nëse vetëm akuzoni, akuzoni, akuzoni e humbni rëndësinë, e humbni mbështetjen. Kjo u pa qartë edhe këtë mars, kur ju pësuar dy humbje të mëdha, një janë zgjedhjet, që për mua janë humbja më e vogël që morët, madje, me sa duket, do t’ju shërbejë për mirë dhe uroj t’ju shërbejë për mirë, sepse ne kemi nevojë për një opozitë serioze dhe të bashkuar. Pra, me fitoren tonë po ju shërbejmë edhe juve. E dyta, humbja juaj më e madhe është disfata që morët kur tentuat të përvetësonit protestën qytetare. Sapo hytë në protestë, ajo u shpërnda. Pra, mirë që nuk bëni dot protestë, përveçse kundër njëri-tjetrit, por nuk ju pranojnë as në protesta. E dini pse? Sepse edhe te qytetarët që protestojnë, jo ata të ndikuar nga rryma të ndryshme, por ata që protestojnë natyrshëm në këtë vend, alternativa gjendet sërish te PS-ja dhe te qeveria e saj, ndaj ju them miqësisht, ringrihuni, pastaj hajdeni dhe jepni versionet tuaja për ta bërë më mire punën në këtë vend. Faleminderit!